



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 2788 / prot. 6

Himarë, më 03.06 . 2026

**Lënda:** Dërgohet për miratim projektvendimi “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 0.79 ha në ekonominë pyjore “Fajeo”, ngastra nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION” SH.P.K., për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**

V

**Himarë**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin nr.57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; VKM-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr. 559 ,datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 0.79 ha në ekonominë pyjore “Fajeo”, ngastra nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION”

SH.P.K., për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.

- Relacion: Mbi projekt vendimin “Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullësor të një sipërfaqe prej 0.79 ha në ekonominë pyjore “Fajeo”, ngastra nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION” SH.P.K., për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.

**KRYETARI**

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**KRYETARI**

Nr. 2788/prot.  
7

Himarë, më 03.06.2026

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 35 , Datë 03.06/2026

**PËR**

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 1 HA NË EKONOMINË PYJORE “FAJEO”, NGA STRA NR.1, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË “EN-BETON”**

**AKTIVITETI:**

**“VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin nr.57/2020, “Për Pyjet”, neni 5; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”; VKM-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr. 559 ,datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”, si dhe në referim të relacionit të paraqitur nga Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

**VENDOSI:**

1. Dhënie e miratimit për dhënie në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1 ha në ekonominë pyjore “fajeo”, nga str. nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “En-Beton” për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për përgatitjen dhe nënshkrimin e kontratës “Për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1 ha në ekonominë pyjore “fajeo”, ngastra nr.1, zk:2863 në favor të shoqërisë “En-Beton” për aktivitetin “VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

**KRYETARI**

Vagjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 2788/prot.  
8

Himarë, më 03.06. 2026

**RELACION:**

**MBI PROJEKT VENDIMIN “DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 (TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 0.79 HA NË EKONOMINË PYJORE “FAJEO”, NGA STRA NR.1, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË “ERAL CONSTRUCTION” SH.P.K.**

**AKTIVITETI:**

**“VENDOSJE KANTIERI DHE DEPOZITIM I MATERIALE INERTE SI PIKË TRANZITI”**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-vendimi që po ju paraqesim vjen pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “ERAL CONSTRUCTION”, e cila ka shprehur interes për marrjen në përdorim të një sipërfaqeje prej 1 ha nga fondi pyjor kulloros në administrim të Bashkisë Himarë, me qëllim zhvillimin e aktivitetit “Vendosje kantieri dhe depozitim i materialeve inerte si pikë tranziti”.

Pas verifikimeve të kryera në terren nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Himarë, është konstatuar se sipërfaqja objekt kërkesë ndodhet në Ekonominë Pyjore “Fajeo”, Ngastra nr.1, ZK 2863 dhe paraqet kushte të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar, pa cenuar interesat publike, fondin pyjor përreth apo ekuilibrat mjedisorë të zonës.

Në vijim të procedurave administrative dhe tekniko-ligjore, si dhe bazuar në raportin tekniko-ekonomik të hartuar nga Drejtoria përgjegjëse, ju paraqitet për shqyrtim dhe miratim ky projekt-vendim.

I. Baza Ligjore

Ky relacion mbështetet në legjislacionin në fuqi, konkretisht:

- Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54;
- VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”;
- Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5;
- VKM nr. 592, datë 09.10.2018, “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, datë 10.10.2008”;
- VKM nr. 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës...”;
- VKM nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”.

## II. Qëllimi i Projekt-Vendimit

Projekt-vendimi synon dhënie e miratimit për përdorimin e një sipërfaqeje prej 0.79 ha nga fondi pyjor kullosor në Ekonominë Pyjore “Fajeo”, Ngastra nr.1, ZK 2863, në favor të shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION”, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Qëllimi i përdorimit të sipërfaqes është:

- Vendosja e kantierit të punimeve;
- Depozitimi i përkohshëm i materialeve inerte;
- Funkcionimi si pikë tranziti dhe mbështetje logjistike për aktivitetet ekonomike të subjektit.

## III. Përshkrimi i Zonës dhe Aktivitetit

Sipërfaqja objekt kërkesë është pjesë e fondit pyjor kullosor në administrim të Bashkisë Himarë dhe ndodhet në Ekonominë Pyjore “Fajeo”, Ngastra nr.1, ZK 2863.

Aktiviteti i propozuar nga shoqëria “ERAL CONSTRUCTION” konsiston në përdorimin e përkohshëm të sipërfaqes për vendosje kantieri dhe depozitimin e materialeve inerte si pikë tranziti, në funksion të veprimtarisë së saj ekonomike.

Nga vlerësimi teknik rezulton se përdorimi i kësaj sipërfaqeje nuk cenon funksionin kryesor të fondit pyjor, nuk prek zona të mbrojtura dhe nuk bie në kundërshtim me dokumentet e planifikimit vendor apo projektet publike të miratuara.

Shoqëria "ERAL CONSTRUCTION" ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave ligjore dhe është angazhuar për respektimin e kushteve mjedisore dhe të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e përdorimit.

#### IV. Argumentimi dhe Përfitimet

Miratimi i këtij projekti sjell përfitime konkrete për Bashkinë Himarë, ndër të cilat:

- Mbështetjen e investimeve private dhe zhvillimit ekonomik lokal;
- Krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për realizimin e aktiviteteve ekonomike;
- Gjenerimin e të ardhurave për Bashkinë Himarë nga përdorimi i pasurisë publike;
- Përdorimin racional dhe të kontrolluar të fondit pyjor kullosor;
- Nxitjen e punësimit dhe zhvillimit ekonomik në territorin e Bashkisë Himarë.

#### V. Përfundime dhe Propozim

Duke u bazuar në kërkesën e paraqitur nga shoqëria "ERAL CONSTRUCTION", dokumentacionin teknik dhe ligjor të administruar, si dhe kuadrin ligjor në fuqi, Bashkia Himarë propozon miratimin e dhënies në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar të një sipërfaqeje prej 0.79 ha nga fondi pyjor kullosor në Ekonominë Pyjore "Fajeo", Ngastra nr.1, ZK 2863.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se sipërfaqja objekt kërkesë është pjesë e fondit pyjor kullosor në administrim të Bashkisë Himarë dhe përdorimi i saj nuk cenon interesin publik, projekte zhvillimore apo përdorime të tjera të miratuara më parë.

Dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqeje vlerësohet në funksion të:

- përdorimit racional dhe ekonomik të fondit pyjor kullosor;
- zhvillimit të aktivitetit ekonomik të subjektit përfitues;
- mbështetjes së investimeve private;
- administrimit efektiv të pasurive natyrore në pronësi të Bashkisë Himarë.

Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak Himarë ftohet të shqyrtojë dhe miratojë projekt-vendimin përkatës.

Bashkëlidhur këtij relacioni:

1. Kopje e hartës topografike me konturet e sipërfaqes objekt kërkesë;

2. Raporti tekniko-ekonomik i vlerësimit të sipërfaqes;
3. Kërkesa e shoqërisë “ERAL CONSTRUCTION” për dhënie në përdorim të sipërfaqes.

DREJTORIA JURIDIKE  
DREJTORI  
Ardit Muhametaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE I UJITJES

Nr. 2788/4 prot.

Himarë, më 03.06.2026

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

ME DELEGIM DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO - EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE  
NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE PYJORE OSE KULLOSORE NË  
PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË HIMARË.

Në përgjigje të kërkesës nr. 2788 prot., datë 16.04.2026, të Shoqërisë “ Eral Construction Sh.p.k” për një sipërfaqe prej 1 ha, në ngastrën nr. 1, Ekonomia Kullosore “Fajeo”, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike.”, Udhëzimin nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, si dhe urdhërit nr.240 datë 06.05.2026 të Kryetarit të Bashkisë, “Për ngritjen e grupit të punës mbi studimin e raportit Tekniko - Ekonomik të kërkesës nr.2788 për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 1 ha, në ngastrën nr.1 të ekonomisë kullosore “Fajeo”, Shoqërisë “En - Beton” shpk, për vendosjen e kantierit dhe depozitimin e materialeve të ndryshme (si pikë tranziti), sipërfaqe në pronësi dhe administrim të Bashkisë Himarë” sipas V.K.M<sup>ë</sup> nr.433, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”.

Mbështetur në planin e rilevimit bashkelidhur raportit ku do të zhvillohet aktiviteti dhe në të dhënat e regjistrit kadastral dhe hartave pyjore dhe/kullosore rezulton se sipërfaqja e kërkuar prej 7900 m2 ndodhet në zonën kadastrale nr. 2863 ekonomia kullosore “Fajeo” parcela nr. 1 dhe është në pronësi / administrim të Bashkisë Himarë bazuar ne V.K.M 433 date 08.06.2016 shtojca 57 .

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes së objektit studimit dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në aneksin nr. 1 dhe nr. 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rrezulton kjo gjendje : (sipas tabelave përkatëse)

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria "EN - BETON" sh.p.k nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit dhe jepen në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar të sipërfaqes prej 1 ha për vendosjen e kantierit.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M<sup>te</sup> nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM<sup>ne</sup> nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe aktiviteteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Himarë, dhe likuidimin e tarifës përkatëse siç është përcaktuar në këtë raport dhe në kontratën përkatëse.

Tarifat e dhënies në përdorim / heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim / përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore", bazohet në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës në kategorinë e përdorimit.

Shuma në lek/vit/ha konsiston në :

<b>Vlerën e përdorimit lekë/vit 0.79ha × 100.000 lekë/ha/vit = 79.000 lekë</b>					
Trungishte	_____	ha	x	_____	lekë/ha/vit = _____ lekë
Cungishte	_____	ha	x	_____	lekë/ha/vit = _____ lekë
Shkurre	_____	ha	x	_____	lekë/ha/vit = _____ lekë
Inproduktive etj	0.79ha	ha	x	100.000	= 79.000 lekë
				lekë/ha/vit	

<b>Vlera e përdorimit për rrugë në km = 0 lekë</b>					
Trungishte	_____	km	x	_____	lekë/km/vit = _____ lekë
Cungishte	_____	km	x	_____	lekë/km/vit = _____ lekë
Shkurre	_____	km	x	_____	lekë/km/vit = _____ lekë
Inproduktive etj	_____	km	x	_____	lekë/km/vit = _____ lekë

### PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO - EKONOMIK

z.Arjan Panajoti

Ing. Ilia Dhimojani

Ervis Halilaj

Mina Prifti










Bashkia Himare

LISTA E NGASTRAVE DHE NNGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË  
PËRDORIM SHOQËRISË EN - BETON SH.P.K

Formulari 5

Nr	ID e Pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosor	Ng/n/ngast	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor, kullosor ha	Sipërfaqja që jepet në përdorim nga fondi pyjor/kullosor	Gjatësia në përdorim km		
						Rrugë	Linjë	Tubacion/kanal
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	VL0400001	FAJEO	1		0.79 Ha	0, Km		
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
				0		0	0	0





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA HIMARË  
SEKTORI I SEKRETARISË DHE I ARKIVIT  
ZYRA E SEKRETARISË

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Shoqëria "Eral Construction Company" shpk

Nr. 617 prot.

Data 17.03.2026

Shkurtimi i lëndës: Kërkesë për zgjedhje të afatit të kontratës së qirasë

Për trajtim nga :	<u>dr. e bujqësisë ; dr. juridike</u>
Struktura të tjera të ngarkuara	
Me porosi :	

Afati : Normal {7 ditë} / Prioritet {3 ditë} / Urgjent {brenda ditës} / Pa afat /Për dijeni / Tjetër: ditë/

Data 16.04.2026 Nr. prot. 2788 KRYETARI I BASHKISË: Vangjel Tavo ME URDHËR

Marrë në dorëzim më: 17.04.2026 Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

I kalon për trajtim drejtorisë: dr. bujqësisë

Data 17.04.2026

Me porosi: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

I kalon për trajtim sektorit: Drejtorisë juridike

Data: 17.04.2026

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar me: \_\_\_\_\_ Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar me: \_\_\_\_\_ Përgjegjësi i sektorit

Trajtimi i materialit përfunduar me: \_\_\_\_\_ Drejtori

Nr. 617 Prot.


Tiranë më 17 mars 2026

Lënda: Kërkesë për zgjatje të afatit të kontratës së qirasë Nr. 1068/1 Prot. Datë 31.03.2023  
me objekt: "Për dhënie në shfrytëzim të sipërfaqeve pronë publike pyjore/kullosore"

Drejtuar: Bashkisë Himarë

Drejtoria e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Pyjeve dhe Kullotave

Adresa: Bashkia Himarë, Spile-Himarë.



### Të nderuar,

Në vijim të marrëdhënies kontraktore të krijuar ndërmjet Bashkisë Himarë dhe shoqërisë **ERAL Construction sh.p.k**, bazuar në Kontratën e Qirasë në fuqi me Nr. 1068/1 Prot., datë 31.03.2023, me objekt: "Për dhënie në shfrytëzim të sipërfaqeve pronë publike pyjore/kullosore", me afat fillimi më 03.04.2023 dhe afat përfundimi më 03.04.2026, ju parashtrijmë këtë kërkesë për zgjatje kontrate.

Shoqëria **ERAL Construction sh.p.k** ka ushtruar aktivitetin e saj në objektin e marrë me qira në përputhje të plotë me destinacionin e përcaktuar në kontratë dhe aktet ligjore në fuqi, duke respektuar detyrimet kontraktore, kushtet teknike dhe administrative, si dhe duke garantuar një marrëdhënie korrekte, transparente dhe të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionin e Bashkisë Himarë.

Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, marrëdhënia kontraktore ka rezultuar funksionale dhe pozitive, pa problematika apo shkelje, çka përbën një bazë të qëndrueshme për vijimin e saj edhe në të ardhmen.

Për sa më lart:

**shprehim interesin tonë për zgjatjen e afatit të kontratës së qirasë për sipërfaqen 7900 m<sup>2</sup> (harta bashkëngjitur), duke filluar nga data e përfundimit të kontratës aktuale deri në një afat 10 vjeçar.**

Shoqëria jonë mbetet e hapur për diskutimin në rast se Autoriteti Kontraktues Bashkia Himarë dëshiron të rishikojë kushtet kontraktuale siç parashikohet në kontratë, në funksion të gjetjes së një zgjidhjeje të kënaqshme për palët, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe interesat respektive.

Kjo kërkesë synon ruajtjen e vijimësisë së aktivitetit ekonomik të ERAL Construction Company shpk, si dhe konsolidimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet palëve, Bashkisë Himarë në rolin e Autoritetit Kontraktues dhe ERAL Construction Company shpk.

Në pritje të shqyrtimit të kërkesës sonë për zgjatjen e kontratës, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim apo dokumentacion shtesë që do të kërkohet.

Me respekt,  
ERAL Construction sh.p.k  
Përfaqësuesi Ligjor  
Ervyn Qëndro

# PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE


POROSITËS: "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" shpk DATË: 17/03/2026 QËLLIMI: KËRKESË PËR QIRA

VENDNDODHJA: PALASË BASHKIA: HIMARË DAVSHKIZVASHK: VLORË ZONA KADASTRALE: 2863 NUMRI I PASURISË: 29/71 INDEX HARTE: K-34-136-(116-C)  
 TË DHËNAT E PASURISË LLOJI PASURISË: KULLOTË SIPËRFAQE E KËRKUAR PËR QIRA = 7900 m<sup>2</sup> SIPËRFAQE E GJURMËS SË NDËRTIMIT NUMRI PEMËVE \_\_\_\_\_

E = 465592.00  
N = 4449127.00

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

E = 467959.78  
N = 4449127.00



**LEGJENDA:**  
Kufiri i sipërfaqes së kërkuar:  
S = 7900 m<sup>2</sup>

KOORDINATAT E S = 7900m <sup>2</sup>		
	E	N
1	465714.77	4448976.71
2	465773.11	4448963.57
3	465821.02	4448960.76
4	465821.71	4448962.96
5	465821.17	4448964.86
6	465823.10	4448966.02
7	465826.75	4448973.39
8	465830.07	4448984.99
9	465775.83	4448996.87
10	465759.87	4449007.57
11	465736.82	4448996.74
12	465685.97	4449081.81
13	465646.48	4449066.41
14	465678.60	4448995.92
15	465681.31	4448989.97

E = 465592.00  
N = 4448780.00

SHKALLA: 1/2500

E = 467959.78  
N = 4448780.00

Nr.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITAR	ID/NIPT	SHËNIME
1	Veri					
2	Jug					
3	Lindje					
4	Perëndim					

**REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT**

EMRI: Ing. DARVIN DAFA

LICENCA : NR. T.1532 DATE 29.10.2021

Darvin  
Dafa  
NENSHKRIMI/VULA

Digitally signed by  
Darvin Dafa  
Date: 2026.03.17  
12:48:40 +02'00'

**TEKNOLOGJIA E MATJEVE: O**

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; Z-Zyre ; O-Ortofoto ; G-Gps ; S-Stacion Total ; D-Matje Distancash

**PËRCAKTIMI I KUFIRIT : HK, P**

Kode për përcaktimin e kufirit : P-Përfaqësues i pronarëve ; K-Kufitarët të Gjithë ; KP-Kufitarët Pjesërisht ; PB-Përfaqësues Bashkie ; HK-Harta Kadastrale ;

**SHËNIME TË VEÇANTA:**

PLANI I RILEVIMIT ËSHTË HARTUAR SIPAS POROSISË SË "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" shpk (Nipt K82230002K) QËLLIMI I PLANIT TË RILEVIMIT ËSHTË KËRKESA PËR QIRAMARRJE.

**PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET**

EMRI \_\_\_\_\_


NENSHKRIMI \_\_\_\_\_

kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit : T-Terren ; Z-Zyre ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Stacion Total ; D-Matje Distancash ; P-Perfaqesues i Pronareve ; K-Kufitarete te Gjithe ; KP-Kufitarete Pjeserisht ; PB- Perfaqesues Bashkie ; HK-Harta Kadastrale

# Fajeo 1



<https://geoportal.asig.gov.al/ofion-te-dhena-geohapesine-re-ofruara-nga-autoritetet-publike-perlegjesa>  
Pergjegjesia per saktesine e te dhenave esente e autoritetit publik qe i ka krijuar ato.



Legjenda	
	Harta
	Topografike
	1:25 000
	Shtese
	Rreth
	Jalat
	rresat
	Rendi 3
	Rendi 2
	Rendi 1 (Kufir)

Sistemi koordinativ: KRGSJSH  
Projektimi: KRGSJSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2863001236  
(Nga \_\_\_\_\_, Në \_\_\_\_\_)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 2863, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 297, Sipërfaqja Totale  
217375 m<sup>2</sup>,  
(Nga të Cilat Tërthi 0 m<sup>2</sup>; Ndërtesë 0 m<sup>2</sup>)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-(116-C), Numri i Pemëve: 0,  
Adresa e Pasurisë: Bashkia \_\_\_\_\_, Rruga \_\_\_\_\_, Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_, SH/K -1, Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_  
Vlera e Pasurisë:  
Fillëstare \_\_\_\_\_ Leke (Akti Nr. \_\_\_\_\_, Dt \_\_\_\_\_), Rivlerësim \_\_\_\_\_ (Akti Nr. \_\_\_\_\_, Dt \_\_\_\_\_)

**B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT \_\_\_\_\_, Pjesa Takuese 0/100, Lloji i Pronësisë: I  
Adresa e Pronarit: Bashkia \_\_\_\_\_, Rruga \_\_\_\_\_, Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_, SH/K -1, Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_  
Regjistruar: Nr. LN.2021, Datë: 08/01/2021

\*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Deputueshme për Pasurinë Nr. \_\_\_\_\_, me Kod Unik \_\_\_\_\_

**B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_  
Përshkrimi i Objektit të Aktit: \_\_\_\_\_  
Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_